REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr 2014/1 Prot.

Lushnje, më 01/03/2024

PROJEKT- VENDIM

NR. 24 DATË 01/03/2024

PËR

"DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.117 DATË 21.12.2023 PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE,ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E LUSHNJES DHE PENALITETET PËR KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2024 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur,në mbështetje të nenit 8 pika 2,nenit 9,pika 1.3,shkronja"b"nenit 54 shkronja"f"të Ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore",i ndryshuar;,ligj nr.89/2022 "Për Policinë Bashkiake"Ju

PROPOZOJMË:"

1. Të shtohet pika 9 në nenin 69(Baza dhe niveli tarifës) me këtë përmbajtje:

9. Niveli i gjobave në ambientin e përbashkët	
a. Shfrytëzimi i zonave të përbashketa brenda ose jashtë godinës së baniminit,si shkallët,sheshpushimet,tarracat,verandat e përbashkëta,lulishtet dhe vendkalimet nuk do të përdoren për ruajtje,parkime ose të bllokohen. b. Ndalohet shkundja e tapetëve nga ballkoni,apo brenda mjediseve të përbashkët.	5000(pesëmijë) lek

c. Ndalohet lënia e mbeturinave në ambientet e përbashkët. d. Ndalohet lënia e sendeve të përdorura dhe material ndërtimi në ambientet e përbashkët,qoftë dhe përkohësisht etj. e. Ndalohet vendosja e mjeteve motorike,biçikletë apo sende të tjera personale,nuk duhet të bllokojnë rrugët e hyrjes etj f. Ruajtja e qetësisë në ambientet e përbashkët.	

2. Të shtohet pika 10 në nenin 69(Baza dhe niveli tarifës) me këtë përmbajtje:

10. Kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike.	
a. Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip jo më të gjatë se 1.5 (një pikë pesë) metra. b. Të vendosin maskat mbrojtëse për qentë e racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, dobermen, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser. c. Të shmangin ndotjen e ambienteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirave publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje, të pastrojnë ambientin pas defektimit. d. Të kryejnë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit. e. Të vaksinojnë dhe kontrollojnë pranë mjekut të klinikës veterinare, kafshët/shpendët e shoqërimit dhe ato të luksit. f. Të respektojnë mirëqenien e kafshëve/shpendëve të tyre. g. Ndalohet kategorikisht, mbajtja në errësirë të plotë, të përhershme dhe/ose të lidhur gjatë gjithë kohës i kafshëve/shpendëve shtëpiake, të shoqërimit dhe të luksit. h. Personat, të cilët mbajnë kafshë/shpendë shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo në bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe të shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjesëtarët e tjerë të komunitetit, duke cenuar gëzimin e qetë të pronës së tyre. i. Mbajtja dhe/ose rritja e kafshëve, bagëtisë ose shpendëve të çdo lloji, pavarësisht numrit është e ndaluar brenda të gjitha njësive të banimit ose pronës së përbashkët. j. Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve blegtoralë jo shtëpiake, në mjedise publike të qendrave urbane si: kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula) etj; b. Ndërsen kafshët kundër njëra – tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre	1000 (njëmijë)lek Dhe dyfish në rast përsëritje

k. Ndërsen kafshët kundër njëra – tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre	10.000(dhjetë mijë)lek Dhe dyfish në rast përsëritje

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Policia Bashkiake, Drejtoria e të Ardhurave Vendore,Njësia Administrative.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore

Donald Nushi

Drejtoria Juridike,Prokurimeve dhe Aseteve

Bedri Hida

P/ Dritan Doso

Policia Bashkiake

Agron Hajdari

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË